

VENDIM
Nr.758, datë 6.12.2005

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR 1997 “PROGRAMI I MBROJTJES SË MJEDISIT TË LIQENIT TË OHRIT/KOMPONENTI I FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 1997 “Programi i mbrojtjes së mjedisit të liqenit të Ohrit/komponenti i furnizimit me ujë të pijshëm”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR 1997
PROGRAMI I MBROJTJES SË MJEDISIT TË LIQENIT TË OHRIT- KOMPONENTI
I FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë,

Në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë,

Duke u nisur nga dëshira për t’i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë,

Të ndërgjegjshëm se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje,

Me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë,

Duke iu referuar bisedimeve ndërqeveritare të datës 2 dhjetor 2004 dhe bisedave të punës të datës 16 mars 2005,

u morën vesh si vijon:

Neni 1

1.Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë u jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe marrësve të tjerë që do të zgjidhen bashkërisht nga të dyja palët kontraktuese, të marrin nga Kreditanstalt Fur Wiederaufbau (KFW), Frankfurt mbi Majn, një hua me vleftë prej gjithsej 4 882 837,47 EUR (me fjalë: katër milionë e tetëqind e tetëdhjetë e dy mijë e tetëqind e tridhjetë e shtatë euro e dyzet e shtatë cent) për projektin “Programi i mbrojtjes së mjedisit të liqenit të Ohrit-komponenti i furnizimit me ujë të pijshëm”, kur nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t’u mbështetur.

2. Po të merren vesh Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, projekti i përmendur në paragrafin 1 mund të zëvendësohet me projekte të tjera. Në qoftë se projekti i përmendur në paragrafin 1 do të zëvendësohet me një projekt, i cili plotëson kushtet e posaçme për mbështetjen nëpërmjet një shume financimi, si projekt i mbrojtjes së mjedisit ose të infrastrukturës sociale, ose si fond garantues të kredive për ndërmarrje të mesme, ose

si masë e cila i shërben përmirësimit të pozitës shoqërore të grave, ose si masë, e cila synon luftimin e varfërisë, duke u mbështetur në parimin e vetëdihmës, atëherë mund të jepet një shumë financimi, përndryshe mund të jepet një hua.

3.Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt fur Wiederaufbau hua ose shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose shuma financimi dhe masat të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 2, atëherë gjen zbatim kjo marrëveshje.

Neni 2

Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratën që do të përfundohet midis Kreditanstalt fur Wiederaufbau dhe huamarrësit, kontratë e cila u nënshtrohet dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1 do të zhvleftësohet në rast se kontrata përkatëse për hua nuk përfundohet brenda një afati prej 8 vjetësh pas vitit të premtimit. Për shumën në fjalë ky afat mbaron në datë 31 dhjetor 2005.

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është huamarrësi, do të garantojë ndaj Kreditanstalt fur Wiederaufbau të gjitha pagesat në euro, për plotësimin e detyrimeve të huamarrësve në bazë të kontratës, e cila do të përfundohet sipas paragrafit 1.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e liron Kreditanstalt fur Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë, lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratës së përmendur në nenin 2.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore që rezultojnë nga dhënia e huasë, nuk merr asnjë masë e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe nxjerr në rastet e duhura lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, më datë 14.11.2005 në dy origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.